



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 133

Tiranë – E hënë, 19 qershor 2017

## PËRMBAJTJA

	Faqe	
Vendim i Kuvendit nr. 80/2017, datë 17.6.2017	Për një ndryshim dhe shtesë në vendimin e Kuvendit nr. 45/2017 “Për krijimin dhe përbërjen e komisionit <i>ad hoc</i> me 12 anëtarë të përzgjedhjes së kandidatëve për institucionet e rivlerësimit, sipas ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me vendimin e Kuvendit nr. 73/2017.....	6781
Vendim i Kuvendit nr. 81/2017, datë 17.6.2017	Për një shtesë në vendimin e Kuvendit nr. 46/2017 “Për krijimin dhe përbërjen e komisionit <i>ad hoc</i> me 6 anëtarë të përzgjedhjes së kandidatëve për institucionet e rivlerësimit, sipas ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me vendimin e Kuvendit nr. 74/2017.....	6781
Vendim i Kuvendit nr. 82/2017, datë 17.6.2017	Për miratimin e listës në bllok të kandidatëve të zgjedhur në institucionet e rivlerësimit, sipas ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.....	6782
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 474, datë 8.6.2017	Për një rishpërndarje të fondeve të buxhetit të vitit 2017, miratuar për Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave...	6783
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 475, datë 8.6.2017	Për pjesëmarrjen e një toge të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacionin ushtarak të Nato-s në Letoni.....	6783
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 476, datë 9.6.2017	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2017, miratuar për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për monitorimin e fushatës zgjedhore të partive politike në zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, më 25 qershor 2017.....	6784



**VENDIM**  
**Nr. 80/2017**

**PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË  
VENDIMIN E KUVENDIT NR. 45/2017  
“PËR KRIJIMIN DHE PËRBËRJEN E  
KOMISIONIT *AD HOC* ME 12 ANËTARË  
TË PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE  
PËR INSTITUCIONET E RIVLERËSIMIT,  
SIPAS LIGJIT NR. 84/2016, “PËR  
RIVLERËSIMIN KALIMTAR TË  
GJYQATARËVE DHE PROKURORËVE NË  
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”,  
NDRYSHUAR ME VENDIMIN E  
KUVENDIT NR. 73/2017**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, të neneve 21, pika 2, dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, si dhe të nenit 9, pika 3, shkronjat “a” dhe “b”, të vendimit të Kuvendit nr. 40/2017 “Për procedurat parlamentare për funksionimin e komisioneve *ad hoc* dhe realizimin e procesit të votimit, sipas ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e kryetarëve të grupeve parlamentare,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në vendimin e Kuvendit nr. 45/2017 “Për krijimin e Komisionit Parlamentar *ad hoc* me 12 anëtarë të përzgjedhjes së kandidatëve për institucionet e rivlerësimit, sipas ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, bëhet ndryshimi dhe shtesa si më poshtë:

I. Në pikën II, shkronja “b”, deputeti Gerti Bogdani caktohet në vend të deputetes Jorida Tabaku.

II. Pas pikës II/1 shtohet pika II/2 me këtë përmbajtje:

“II/2. Anëtarë zëvendësues të këtij Komisioni *ad hoc* caktohen deputetët:

1. Olta Xhaçka (PS)
2. Luçiano Boçi (PD)
3. Flamur Çelaj (LSI)
4. Astrit Veliaj (PR)
5. Aqif Rakipi (PDIU)”.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**  
**Ilir Meta**

Miraturar në datën 17.6.2017

**VENDIM**  
**Nr. 81/2017**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E  
KUVENDIT NR. 46/2017 “PËR  
KRIJIMIN DHE PËRBËRJEN E  
KOMISIONIT *AD HOC* ME 6 ANËTARË  
TË PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE  
PËR INSTITUCIONET E RIVLERËSIMIT,  
SIPAS LIGJIT NR. 84/2016, “PËR  
RIVLERËSIMIN KALIMTAR TË  
GJYQATARËVE DHE PROKURORËVE NË  
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”,  
NDRYSHUAR ME VENDIMIN E  
KUVENDIT NR. 74/2017**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, të neneve 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, si dhe të nenit 9, pika 3, shkronjat “a” dhe “b”, të vendimit të Kuvendit nr. 40/2017 “Për procedurat parlamentare për funksionimin e komisioneve *ad hoc* dhe realizimin e procesit të votimit, sipas ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e kryetarëve të grupeve parlamentare të Partisë Socialiste, Partisë Demokratike dhe Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në vendimin e Kuvendit nr. 46/2017 “Për krijimin e Komisionit Parlamentar *ad hoc* me 6 anëtarë të përzgjedhjes së kandidatëve për institucionet e rivlerësimit, sipas ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar” bëhet kjo shtesë:

I. Pas pikës II/1 shtohet pika II/2 me këtë përmbajtje:

“II/2. Anëtarë zëvendësues të këtij Komisioni *ad hoc* caktohen deputetët:



1. Musa Ulqini (PS)
2. Helidon Bushati (PD)
3. Silva Caka (LSI)”.  
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**  
**Ilir Meta**

Miratur në datën 17.6.2017

**VENDIM**  
**Nr. 82/2017**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS NË BLOK  
TË KANDIDATËVE TË ZGJEDHUR  
NË INSTITUCIONET E RIVLERËSIMIT,  
SIPAS LIGJIT NR. 84/2016 “PËR  
RIVLERËSIMIN KALIMTAR TË  
GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE  
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit C, pika 12, të Aneksit të Kushtetutës, të neneve 10, pika 10, dhe 11, pika 1, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 17, pikat 2 dhe 8, të vendimit të Kuvendit nr. 40/2017 “Për procedurat parlamentare për funksionimin e komisioneve *ad hoc* dhe realizimin e procesit të votimit, sipas ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, bazuar në listën përfundimtare të komisionerëve, gjyqtarëve dhe komisionerëve publikë të zgjedhur, të hartuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, sipas raporteve të komisioneve *ad hoc* të përzgjedhjes,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

I. Miratohet lista në bllok e kandidatëve të zgjedhur në institucionet e rivlerësimit, sipas ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

II. Lista në bllok e kandidatëve të zgjedhur në institucionet e rivlerësimit është si më poshtë:

- |    |                       |  |
|----|-----------------------|--|
| 1. | Etleda Çiftja         | Komisioner në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit |
| 2. | Firdes Shuli          | Komisioner në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit |
| 3. | Genta Tafa<br>(Bungo) | Komisioner në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit |

- |     |                              |   |
|-----|------------------------------|---|
| 4.  | Xhensila Pine                | Komisioner në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit                            |
| 5.  | Brunilda<br>Bekteshi (Vasha) | Komisioner në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit                            |
| 6.  | Roland Ilia                  | Komisioner në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit                            |
| 7.  | Suela Zhegu                  | Komisioner në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit                            |
| 8.  | Valbona<br>Sanxhaktari       | Komisioner në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit                            |
| 9.  | Pamela Qirko                 | Komisioner në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit                            |
| 10. | Alma Faskaj<br>(Vokopola)    | Komisioner në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit                            |
| 11. | Lulzim Hamitaj               | Komisioner në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit                            |
| 12. | Olsi Komici                  | Komisioner në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit                            |
| 13. | Vojo Malo                    | Zëvendësues për pozicionin Komisioner në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit |
| 14. | Pal Shkambi                  | Zëvendësues për pozicionin Komisioner në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit |
| 15. | Ardian Hajdari               | Gjyqtar i Kolegjit të Posaçëm të Apelit                                       |
| 16. | Natasha Mulaj                | Gjyqtar i Kolegjit të Posaçëm të Apelit                                       |
| 17. | Sokol Çomo                   | Gjyqtar i Kolegjit të Posaçëm të Apelit                                       |
| 18. | Ina Rama                     | Gjyqtar i Kolegjit të Posaçëm të Apelit                                       |
| 19. | Luan Daci                    | Gjyqtar i Kolegjit të Posaçëm të Apelit                                       |
| 20. | Albana Shtylla               | Gjyqtar i Kolegjit të Posaçëm të Apelit                                       |
| 21. | Rezarta Schuetz              | Gjyqtar i Kolegjit të Posaçëm të Apelit                                       |
| 22. | Mimoza Tasi                  | Zëvendësues për pozicionin Gjyqtar i Kolegjit të Posaçëm të Apelit            |
| 23. | Etleva Papekaj               | Zëvendësues për pozicionin Gjyqtar i Kolegjit të Posaçëm të Apelit            |
| 24. | Herald Saraçi                | Komisioner Publik   |
| 25. | Florian Ballhysa             | Komisioner Publik   |
| 26. | Dariel Sina                  | Zëvendësues për pozicionin Komisioner Publik                                  |
| 27. | Aldona Sylaj                 | Zëvendësues për pozicionin Komisioner Publik.                                 |



III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet ne Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Ilir Meta

Miraturar në datën 17.6.2017

**VENDIM**  
**Nr. 474, datë 8.6.2017**

**PËR NJË RISHPËRNDARJE TË  
FONDEVE TË BUXHETIT TË VITIT  
2017, MIRATUAR PËR MINISTRINË E  
BUJQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL DHE  
ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, dhe të neneve 44, shkronja “a”, dhe 47, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në buxhetin e vitit 2017, miraturar për Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Në programin buxhetor “Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit” 04220, shtohet fondi prej 148 000 000 (njëqind e dyzet e tetë milionë) lekësh, shpenzime korrente, për vaksinimin e kafshëve të llojit gjedh kundër sëmundjes së Dermatozës Nodulare (*Lumpy Skin Disease*);

b) Në programin buxhetor “Zhvillimi rural duke mbështetur bujqësinë, blegtorinë, agroindustrinë dhe marketingun”, pakësohet fondi prej 148 000 000 (njëqind e dyzet e tetë milionë) lekësh, shpenzime korrente, nga skema mbështetëse për bujqësinë.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Edi Rama

**VENDIM**  
**Nr. 475, datë 8.6.2017**

**PËR PJESËMARRJEN E NJË TOGE  
TË FORCAVE TË ARMATOSURA  
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË  
OPERACIONIN USHTARAK TË NATO-S  
NË LETONI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6, pika 5, dhe 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe të kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “ç”, të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Dërgimin me mision të një toge EOD, të përbërë nga 18 (tetëmbëdhjetë) ushtarake të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, në operacionin ushtarak të NATO-s në Letoni.

2. Misioni i personelit të togës EOD është kryerja e detyrave në mbështetje të grupbatalionit të Kanadasë.

3. Togës EOD, që merr pjesë në këtë mision, nuk i lejohet të angazhohet për asgjësim municionesh CBRN, ndërtim fushash të minuara (FM) dhe detyra trajnimit për të tjerët.

4. Venddislokimi i togës EOD të jetë në Riga, Letoni.

5. Kohëzgjatja e këtij misioni është deri në 1 (një) vit, afat, i cili fillon të llogaritet nga data e dërgimit të togës së parë në Letoni, me sistem rotacioni. Periudha e rotacionit për çdo togë të jetë 6 (gjashtë) muaj, së cilës i shtohen edhe ditët e qëndrimit për ndërrimin me togën e radhës.



6. Ministria e Mbrojtjes, për ushtarakët pjesëmarrës në këtë operacion, të përballojë shpenzimet për:

- a) dieta për ditët e qëndrimit, në masën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në ditë, përveç pagës mujore;
- b) sigurimin e jetës;
- c) siguracion shëndetësor jashtë zonës së operacionit;
- ç) mbështetje shëndetësore;
- d) ushqim;
- dh) akomodim;
- e) ujë;
- ë) lavanderi;
- f) shërbim telefonik, interneti, konfigurim PC në rrjetin “NATO Sekret” dhe shërbime postare;
- g) materiale konsumi për aparatura;
- gj) mirëmbajtje pajisjesh dhe aparaturash;
- h) transport;
- i) transportimin e individëve të shkëputur të misionit për në atdhe, në rast vdekjeje, sëmundjeje ose thyerjeje disipline;
- j) aktivitete social-kulturore, në rastet e festave kombëtare, gjatë kohës së kryerjes së misionit;
- k) çdo shpenzim tjetër për mbarëvajtjen e kryerjes së operacionit.

7. Transporti i personelit që do të marrë pjesë në misionin në Letoni ndërsa nis, ndryshon dhe përfundon detyrën për t'u kthyer në Shqipëri, mbështetja shëndetësore, akomodimi, ushqimi, uji, lavanderia, transporti i individëve të shkëputur nga operacioni për në atdhe, në rast vdekjeje, sëmundjeje ose thyerjeje disipline, do të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes, përveç rasteve kur do të arrihet nënshkrimi i marrëveshjeve dy ose shumëpalëshe, ku pala /palët tjetër/e tjera të marrë/marrin përsipër të përballojë/përballojnë këto shpenzime.

8. Ministria e Mbrojtjes të bëjë sigurimin e jetës nga aksidentet për ushtarakët e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të cilët do të marrin pjesë në këtë mision.

9. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.

10. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Edi Rama

**VENDIM**  
**Nr. 476, datë 9.6.2017**

**PËR NJË SHITESË FONDI NË  
BUXHETIN E VITIT 2017, MIRATUAR  
PËR KOMISIONIN QENDROR TË  
ZGJEDHJEVE, PËR MONITORIMIN E  
FUSHATËS ZGJEDHORE TË PARTIVE  
POLITIKE NË ZGJEDHJET PËR  
KUVENDIN E REPUBLIKËS SË  
SHQIPËRISË, MË 25 QERSHOR 2017**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 86, pika 2, dhe 87, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të pikës 1, të nenit 24/4, të ligjit nr. 90/2017, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8580, datë 17.2.2000, “Për partitë politike”, të ndryshuar, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në buxhetin e miratuar për vitin 2017, t'i shtohet fondi prej 10 000 000 (dhjetë milionë) lekësh për të kryer monitorimin e fushatës zgjedhore të partive politike, në kuadër të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, më 25 qershor 2017.

2. Fondi prej 10 000 000 (dhjetë milionë) lekësh, i parashikuar në pikën 1, të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2017.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Edi Rama

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2017

Adresa:  
Bulevardi “Gjergj Fishta”  
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”

Çmimi 32 lekë